

UDHËZUES

Për trajnime pedagogjike të mësimdhënësve

Botuesi:

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur

Përgatitur nga: Fikrije Zymberi

Për botuesin: Ragip Gjoshi

Redaktor gjuhësor: Berat Dakaj

Dizajni dhe përgatitja për shtyp: Gëzim Berisha
Jetmir Berisha

Përmbajtja:

Contents

Hyrje	4
3. Trajnimi i mësimeve	6
4. Kurset pedagogjike/didaktike	11
Kursi për zhvillimin optimal të materialeve trajnuese	12
Kursi për shfrytëzimin e trajnimeve të bazuara në projekte	12
Kursi për punën me objektiva mësimore	12
Kursi për promovimin dhe shfrytëzimin e qasjes së mësimeve	15
Kursi për shfrytëzimin e trajnimit të bazuar në projekte	16
Kursi për punën me objektiva mësimore	17
Korniza logjike për intervenimet e propozuara	20
<i>Shtojca A - Materialet e shqyrtuara</i>	20
Raportet nga trajnimet e mbajtura	20

Hyrje

Agjencia për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr) është themeluar në bazë të Ligjit të Arsimit Profesional, nenit 13. Prioritet kryesor i kësaj Agjencie është t'i integrojë arsimin, aftësimin profesional dhe arsimin e të rriturve në kontekstin evropian; ta bëjë promovimin dhe krijimin e qëndrueshëm të vendeve të reja të punës përmes përmirësimit të klimës afariste për bizneset dhe përmes shtimit të mundësive të punësimit për nxënësit e diplomuar në shkollat e mesme të larta profesionale.

Trajnimi dhe aftësimi profesional i mësimitdhënësve të QK dhe shkollave profesionale në fokus gjatë periudhës pilote paraqet një fushë që kërkon vëmendje politike dhe veprime strategjike. Suksesi i reformave të shkollave profesionale kërkon që mësimitdhënësit dhe trajnuesit të kenë dijeni të azhurnuara mbi lëndët e tyre, si dhe të kenë shkathtësi pedagogjike dhe të gëzojnë përkrahje për zhvillimin e aftësive dhe karrierave të tyre.

Materialet relevante trajnuese, pajisjet laboratorike, punëtoritë e këtyre shkollave profesionale mund të japin efekt të pranueshëm tek nxënësit dhe tek të tjerët vetëm nëse mësimitdhënësit dhe trajnuesit kanë kapacitetet e duhura për ta kryer punën e tyre në pajtim me standardet e kërkuara dhe me pritjet e tregut të punës.

Janë përzgjedhur katër QK dhe dy shkolla profesionale, të cilat janë mirë të pajisura dhe me hapësira të mjaftueshme mësimore.

Në bazë të studimeve të mëhershme është zbuluar se në arsimin profesional në Kosovë deri në 80 % të nxënësve të shkollave të larta profesionale pas diplomimit nuk arrijnë të gjejnë vende pune. Ky disproporcion mund të sqarohet pjesërisht me cilësinë e ulët të punës së mësimitdhënësve të shkollave profesionale. Këta mësimitdhënës nuk kanë kualifikimet e domosdoshme për t'ua lehtësuar nxënësve tranzicionin nga shkolla në punë.

Përveç kësaj, rolet e mësimitdhënësit dhe trajnuesit janë duke pësuar ndryshime të mëdha, siç janë kalimi nga bartësi i thjeshtë i njohurive në një aftësues të mirëfilltë me njohuri përkatëse dhe kalimi nga mësimitdhënia në baza planprogramesh në mësimitdhënie të bazuar në objektiva mësimore të cilat definojnë se çfarë pritet të dinë nxënësit në fund të kursit dhe çfarë pritet nga ta të jenë në gjendje të bëjnë në fund të procesit mësimor. Kalimi nga procesi i mësimitdhënies tek mësimitdhëni në proces që fokusohet tek nxënësi, paraqet një çështje esenciale të tërë kësaj pune.

Në bazë të kushteve dhe objektivave të parashtruara AAAPARr-ja ka për detyrë t'i ngrehë kapacitetet gjatë periudhës pilote dyvjeçare. Pritet që ngritja e aftësive dhe shkathtësive të mësimitdhënësve të IAAP të përzgjedhura të shërbejë si hallkë e rëndësishme në ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme të të gjitha shkollave të mesme të larta profesionale të Kosovës.

1.1. Objektivat

Një ndër objektivat e AAAPARr-s do të jetë ngritja e rezultateve të nxënësve/klientëve dhe nivelit të mësimitdhënies në shkolla profesionale përmes ngritjes së kapaciteteve të mësimitdhënësve të shkollave profesionale me qëllim të lehtësimit të kalimit të tyre në tregun e punës. Përveç kësaj, aktivitetet e planifikuara do të kenë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave dhe të gjitha palëve me interes në proceset pedagogjike.

1.2. **Elaborimi i objektivave**

Aktivitetet sa i përket trajnimit të mësimeve duhet të bazohen në njohuri solide sa i përket nivelit të kapaciteteve të mësimeve të shkollave profesionale dhe të përcaktohen prioritetet për aktivitetet e mundshme pedagogjike dhe didaktike. Si rrjedhojë, pikënisje për tërë këtë intervenim duhet të jetë analiza e kapaciteteve institucionale të mësimeve dhe trajnuesve në shkollat profesionale dhe qasjes së tyre në aktivitete të ngritjes profesionale dhe pedagogjike. Analiza institucionale do të fokusohet në kapacitetin dhe aftësinë e mësimeve aktualë të shkollave profesionale në fokus. Një analizë më konkrete do të realizohet në formë të analizës SWOT, duke u përqendruar, mes të tjerash, në:

- Përbajtjen dhe fushëveprimin e trajnimeve ekzistuese të mësimeve para punësimit, p.sh. legjislativin ekzistues
- Kurset potenciale të vazhdueshme që mund t'u ofrohen mësimeve
- Ekzistimi i trajnimeve gjatë punësimit për mësimeve të shkollave profesionale
- Ekzistimi i planeve komunale për ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në shkollat profesionale.

Si përfundim janë dy pikat në vijim:

1. Një propozim për intervenimet pedagogjike/didaktike për mësimeve të shkollave profesionale
2. Një plan të punës/matricë në të cilën identifikohen hapat që duhen ndërmarrë, korniza kohore për ndërmarrjen e tyre, resurset e nevojshme dhe indikatorët e progresit.

3. Trajnimi i mësimdhënësve

Trajnimi i mësimdhënësve të shkollave profesionale në Kosovë Historiku dhe të gjeturat

3.1. Historiku

Ngjashëm me shtetet e tjera të Evropës jugore, Kosova duhet të ndërtojë një model të decentralizuar të arsimit (konform ligjeve në fuqi). Gjatë periudhës para fillimit të viteve '90-tave shtetet e Evropës juglindore (EJL) funksiononin me sisteme mjaft të ngjashme arsimore, përmes të cilave përqeshin t'u përgjigjeshin në mënyrë adekuate ndryshimeve në tregun e punës, kryesisht për shkak të industrializimit të vendeve, të cilët kërkonin fuqi të aftë punëtore. Sistemet e arsimit profesional në shtetet e EJL-së kryesisht konsideroheshin stabile dhe relativisht të avancuara në krahasim me shtetet e tjera të Evropës.

Një dekadë konfliktesh ka rezultuar me një rënie të fuqishme të sistemeve arsimore në EJL në përgjithësi dhe të shkollave profesionale në veçanti. Ky zhvillim bëri që në shoqëri të ketë mungesë të personave të kualifikuar në shkolla profesionale dhe që në këtë industri të bie konkurrenca. Kjo është zëvendësuar me një periudhë reformash. Madje, edhe nëse kushtet dhe tiparet e shkollave profesionale dallojnë mes shteteve të EJL-së, disa nga trendët kryesorë që mund të identifikohet janë:

- Promovimi dhe implementimi i mjeteve dhe skemave për decentralizimin e shkollave profesionale
- Shtimi i cilësisë dhe atraktivitetit të shkollave profesionale
- Përmirësimi i lidhjeve mes shkollave profesionale dhe tregut të punës
- Fuqizimi i shkollave profesionale, në kuptim të dhënies së një niveli më të lartë të autonomisë dhe vetëqeverisjes
- Fokusimi i shtuar në profesionalizmin e mësimdhënësve të shkollave profesionale dhe të qasjeve mësimdhënëse në to.

Këto prioritete janë frymëzuar nga trendët politikë të BE-së sa i përket shkollimit profesional, të përcaktuara, për shembull, në Deklaratën e Kopenhagës dhe Strategjinë e Lisbonës, dhe pasqyrojnë aspiratat e shteteve të EJL-së për t'u bërë anëtare të BE-së.

Njëkohësisht duhet të kemi parasysh se:

Sistemet e arsimit profesional, në veçanti qendrat e arsimit profesional, janë të ndjeshme dhe të paanalizuara sa duhet. Përvoja nga shtetet me histori të gjata dhe traditë në arsim profesional na mëson se zhvillimi merr kohë, mes të tjerash, për shkak se në këtë proces përfshihen më shumë palë me interes sesa në procesin e arsimit të përgjithshëm të mesëm. Përveç kësaj, shtetet e EJL-së, ngjashëm me shumë shtete të tjera evropiane, përballen me faktin se arsimimi profesional gëzon reputacion të keq tek nxënësit dhe prindërit. Kjo ndodh edhe në Kosovë. Si shtet i ri, ky vend përballlet me një sërë sfidash dhe pengesash gjatë krijimit të një tregu efektiv të punës të cilit i përgjigjet sistemi i arsimit profesional.

3.2. Edukimi fillestar dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe trajnuesve në shkolla profesionale - trendët në Evropë

Në dhjetë vjetët e fundit rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve dhe trajnuesve në shkolla profesionale kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në një numër të madh të vendeve, duke u bërë multifunksionale dhe duke kombinuar një sërë elementesh profesionale me tipare të tjera të palëve të tjera me interes në arsim profesional. Edhe në Kosovë vërehet ky trend. Pasi që kërkesa për inovacion dhe reformë sistemore është shtuar, njëjtë është shtuar edhe nevoja për ndryshime të cilat rezultojnë me mundësi të reja për mësimdhënësit dhe trajnuesit e shkollave profesionale, të cilët duhet të punojnë më për së afërmi me përfituesit kyçë të shërbimeve të tyre, përfshirë edhe ndërmarrjet dhe përfaqësuesit e tyre, mes të tjerash:

- Duke ua dhënë mundësinë shkollave në nivel lokal që të ndërtojnë ura me ndërmarrje dhe komunitete
- Duke u lejuar mësimdhënësve dhe trajnuesve marrjen e nismave për të krijuar partneritete lokale mes shkollave profesionale, punëdhënësve dhe rrjeteve të përfituesve të shkollimit profesional, përfshirë angazhimin e mësimdhënësve në industrinë dhe shërbimet lokale, qoftë publike, qoftë private
- Duke kombinuar autonominë e shkollave dhe mësimdhënësve me shtim të llogaridhënies kundrejt palëve me interes, përfshirë këtu nxënësit dhe prindërit.

3.3. Arsimiti fillestar dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe trajnuesve të shkollave profesionale - gjendja në Kosovë

Vlerësimet janë të bazuara në materialet relevante si: strategjitë kombëtare dhe qeveritare të arsimit, me fokus të veçantë në rolin mësimdhënësve dhe të politikave mbi arsimimin e mësimdhënësve apo rregulloret në lidhje me mësimdhënësit, komunitetet dhe përfshirjen e tyre; katalogët apo përshkrimet e ngjashme të programeve të trajnimeve në vend të punës.

Analiza e zhvillimit profesional të mësimdhënësve të shkollave profesionale në fokus do të bëhet duke iu përgjigjur pyetjeve në vijim:

1. Kush është përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në shkolla profesionale?
2. A fokusohen programet e donatorëve në zhvillimin profesional të mësimdhënësve?
3. Cila është gjendja aktuale dhe cilat janë prioritetet politike në këtë fushë?

2.3.1. Kush është përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në shkolla profesionale?

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve të shkollave profesionale është detyrë e drejtorive komunale të arsimit, ndërsa për fazën pilote (2014/2016) AAAPARr-ja do të jetë përgjegjëse për gjashtë institucionet e arsimit që janë nën menaxhimin e saj.

Përgjegjësitë e tyre mbulojnë tri fushat kyçe në vijim:

- Rekrutimin/punësimin dhe dhënien e pagave për stafin mësimdhënës dhe administrativ në shkolla
- Trajnimin e stafit mësimdhënës dhe administrativ
- Monitorimin e rezultateve të punës së mësimdhënësve.

AAAPARr-ja duhet t'i ndërmarrë hapat e bashkëpunimit në mes të MASHT-it, shkollave, drejtorive komunale të arsimit për ta përmirësuar këtë fushë jetike për arsimin, aftësimin profesional.

2.3.2. Programet e donatorëve që fokusohen në zhvillimin profesional të mësimit të mësimit të mësimit të shkollave profesionale

Trajnime të shumta të mësimit të mësimit janë ofruar gjatë dekadës së fundit, kryesisht për mësimit të shkollave fillore. Këto aktivitete janë financuar nga donatorë të ndryshëm, kurse kryesisht janë implementuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Rrjedhimisht, KEC ka qenë i përfshirë në trajnimin e më se 15 000 mësimit të mësimit lokalë mes viteve 2000 dhe 2008 në fushën e metodologjive inovative, ndërvepruese dhe përfshirëse të mësimit të mësimit. Duhet theksuar se, sipas informatave në dispozicion, mësimit të mësimit e shkollave profesionale nuk janë përfshirë në aktivitete të tilla.

Trajnimet e mësimit të mësimit që specifikuhan kanë pasur për synim mësimit të mësimit e shkollave profesionale kanë qenë të pakta në numër. Nga raportet në arsimin e mesëm profesional janë shkoqitur aktivitetet në vijim:

- KOSVET II, shtator 2004 - shtator 2006, ka ofruar përkrahje të vazhdueshme në kuptim të përgatitjes së planprogrameve dhe standardeve, trajnimeve për mësimit të mësimit dhe trajnerë dhe përmirësim kualitativ të rezultateve të punës në arsimin profesional të mesëm
- IPA 2008 ka ofruar shërbime të trajnimeve nëpër kompani
- Banka Botërore, UNICEF-i dhe KEDP kanë ofruar programe të ndryshme trajnuese të mësimit të mësimit, që kanë mbuluar të gjitha kategoritë e mësimit të mësimit, nga shkollat fillore e deri tek ato të mesme
- Para pesë vjetësh, GIZ-i ka ofruar një sërë kushtesh themelore pedagogjike dhe didaktike për mësimit të shkollave profesionale
- MASHT/Danida gjatë periudhës 2008-2014 kanë realizuar trajnimet si më poshtë:
 - për përdorimin e pajisjeve laboratorike për mësimitin e përpunimit të ushqimit dhe profilet e bujqësisë
 - për punët praktike në sera, plantacione
 - firma ushtrimore si dhe ECDL për katër module
 - kompost
 - përdorimin e mekanizimit bujqësor
 - ndërmarrësisë
 - përdorimit të materialeve mësimit të zhvilluara për katër profile
 - plane zhvillimore të shkollave
 - për përdorimin e bazës së të dhënave për tregun e punës
 - për udhëzime në karrierë
 - trajnim për vetëmenaxhimin e institucioneve arsimore duke përfshirë menaxhmentin.

2.3.3. Gjendja aktuale dhe prioritetet politike në këtë fushë

Mësimit të mësimit të shkollave profesionale kryesisht punësohen drejt nga universitetet dhe në bazë të lëndëve që i kanë studiuar nëpër fakultetet e tyre përkatëse. Në përgjithësi në universitete ofrohet një numër i limituar i kurseve pedagogjike/didaktike.

Fakulteti i Edukimit ka lëndë për metodologjinë profesionale dhe të mësimit të mësimit, por jo edhe mbi praktikën e mësimit të mësimit. Fakulteti i Shkencave Matematikore dhe Natyrore dhe degët përkatëse të tij ofrojnë mundësi studimi për mësimit të mësimit e ardhshëm të biologjisë, gjeografisë, kimisë,

matematikës dhe fizikës të shkollave të mesme të larta të Kosovës. Megjithatë, cilësia dhe rëndësia e këtyre kurseve mbetet tejet e kufizuar.

Fakultetet e tjera si, për shembull, i Mjekësisë, i Ekonomisë, i Arteve, i Drejtësisë apo Bujqësisë nuk ofrojnë aftësi për mësimdhënës, por të diplomuarit nga këto fakultete shpesh punësohen në shkolla të mesme të larta profesionale apo të përgjithshme. Këta të diplomuar nuk kalojnë kurrfarë trajnimit metodologjik dhe të gjitha pengesat detyrohen t'i kalojnë në bazë të përvojës së fituar apo përmes trajnimeve në vend të punës.

Kandidatët marrin këshilla të mira nga kolegët, drejtorët dhe inspektorët e arsimit.

Të gjitha palët me interes, përfshirë mësimdhënësit, menaxherët dhe inspektorët, dhe stafin në nivel ministror dhe komunal, kanë nevojë të madhe për ofrimin e masave për zhvillim profesional të mësimdhënësve. Arsyet kryesore për këtë janë:

- Nxjerrja e nxënësve të cilët plotësojnë kushtet e tregut të punës dhe të cilët do të jenë pajisur me kapacitete përkatëse, gjë që mund të arrihet vetëm në rast se mësimdhënësit janë të aftë dhe të shkathtë
- Programi i Kurrikulit të Ri të Kosovës përcakton qartë objektivat mësimore
- Rolet e reja të mësimdhënësve dhe qasjet e reja ndaj të mësuarit.

Që nga viti 2004 MASHT-i e ka adresuar këtë çështje në kuptim të përcaktimit të synimeve dhe objektivave të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në shkolla profesionale të mesme. Në vitin 2008, Qeveria e re e ka identifikuar sistemin e licencimit të mësimdhënësve si një cak që është duke u plotësuar me prioritet.

Një nga hapat e parë të këtij procesi ishte krijimi i Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve (KSHLM), i cili ka bërë përgatitjen e një sistemi për licencimin e mësimdhënësve:

- Duke paraqitur kornizën për vlerësimin e performansës së mësimdhënësve
- Duke specifikuar procedurat për akreditimin e programeve trajnuese për mësimdhënësit
- Duke krijuar një sistem të kurseve trajnuese për mësimdhënës, të bazuar në merita
- Duke hartuar program obligues të trajnimit në vend të punës për mësimdhënës. Kohëzgjatja e programit të trajnimit në vend të punës parashihej prej 100 orë brenda pesë vjetësh.

Në vitin 2004, në pajtim me kornizën e lartpërmendur, MASHT-i ka sajuar dhe miratuar Standardet e Programeve Trajnuese për Mësimdhënësit para punësimit, me të cilët përcaktohen kushtet specifike që këto programe duhen plotësuar, siç janë: edukimi i përgjithshëm dhe njohuria e lëndës akademike; njohuritë mbi strategjitë e mësimdhënies, të bazuara në praktikë dhe në hulumtime dhe vetëvlerësime të vazhdueshme personale; aftësi në të shkruar; kurse shtesë në psikologji të të mësuarit dhe në metodologjitë e lëndëve të ndryshme; përvojë të caktuar praktike (së paku 22 javë gjatë katër vjetëve studimi); etikë të punës dhe aftësi në komunikim.

Një sfidë e madhe për sistemin e licencimit të mësimdhënësve do të jetë financimi i 100 orëve të trajnimit të detyruar të mësimdhënësve, siç kërkohet me draftversionin e propozimit. Projekti i financuar nga BE: “Qasja mbarësektoriale ndaj arsimit” (SWAP) ka ofruar një parashikim të vrazhdë sa i përket koston së paraparë për trajnimin e 25 000 mësimdhënësve në Kosovë sipas caktit të përcaktuar prej 100 orësh për mësimdhënës gjatë një periudhe pesëvjeçare. Kostoja e gjithëmbarshme do të arrijë 3.2 milionë euro.¹

2.3.4. Roli i inspektorëve të arsimit

Vlen të përmenden specifiku i inspektorëve të arsimit të cilët janë tejet aktivë dhe të përkushtuar që të ofrojnë përkrahje pedagogjike/didaktike për mësuesit të cilët fillojnë karrierat e tyre pa kurrfarë udhëzimesh apo përkrahjesh pedagogjike.

Inspektorët gjithëherë kanë qenë të zëshëm në vlerësimet e tyre mbi kapacitetet joadekuate pedagogjike të mësuesve të shkollave profesionale, pa marrë parasysh përvojën e punës në ato vende. Inspektorët gjithashtu shprehin interes të palëkundur për t'u përfshirë në aktivitetet që kanë për synim zhvillimin pedagogjik të mësuesve në shkollat profesionale.

3.4. Qendra për Arsim e Kosovës - KEC

KEC është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2000. Siç u përmend edhe më sipër, KEC kishte mbajtur trajnime gjatë marrëdhënies së punës për 15 000 mësues lokalë mes viteve 2000 dhe 2008, edhe përmes metodologjive, teknikave dhe qasjeve të ndryshme ndërvepruese dhe përfshirëse, përfshirë shkrimin, leximin dhe të menduarit kritik, të mësuarit hap pas hapi, drejtësinë sociale dhe të drejtat e fëmijëve.

3.5. Programet e tjera të trajnimit për mësues të punësuar

Përveç programeve të KEC-it, gjatë dekadës së fundit janë mbajtur edhe një numër i caktuar i trajnimeve. Ato janë financuar nga donatorë të ndryshëm dhe kanë pasur për cak kryesisht mësuesit e cikleve parashkollore dhe fillore.

Një program i tillë ishte edhe Programi për Zhvillimin e Edukatorëve në Kosovë (KEDP). KEDP u ndihmoi mbi 10 000 mësuesve të shkollave fillore dhe liderëve arsimorë. Fokus kryesor i tij ishte trajnimi dhe rikualifikimi i mësuesve për t'i plotësuar kriteret e caktuara nga MASHT-i.

3.6. Konkluzionet

- Vërehet se po i jepet më shumë vëmendje politike nevojës për ta promovuar zhvillimin profesional të mësuesve të shkollave profesionale
- Fokusi i shtuar pasqyrohet në përpjekjet e MASHT-it për përfundimin e sistemit të licencimit të mësuesve. Është theksuar se mosjetësimi i këtij sistemi të licencimit mund të shpie drejt demotivimit mes mësuesve
- Ka arsye të forta për ekzistimin e një sistemi të tillë, megjithatë duket se resurset e limituara të ndara për sistemin arsimor nuk mundësojnë zhvillimin e mirëfilltë të tij, p.sh., zbatimin e planit për të ofruar 100 orë trajnime për të gjithë mësuesit e punësuar në Kosovë
- Trajnime për mësues të punësuar janë ofruar dhe janë financuar nga donatorë të ndryshëm, por shumë pak prej tyre u janë ofruar mësuesve të shkollave profesionale
- Mbresë e përgjithshme e fituar është se mësuesit e shkollave profesionale kryesisht nuk gëzojnë ndihmë dhe se janë fare pak të mbikëqyrur
- Mësuesve të shkollave profesionale nuk u ofrohet trajnim para punësimit, ndërsa edhe pas punësimit ata nuk gëzojnë përkrahje përkatëse
- Ekziston ende brenga lidhur me mundësitë e zhvillimit profesional për mësuesit e shkollave profesionale
- Të gjithë mësuesit janë të kënaqur për trajnimet e ofruara nga disa donatorë, në veçanti për kurset e GIZ-it dhe të programit MASHT/Danides
- Është e nevojshme që shkollave t'u jepet mundësia për të iniciuar procese vetjake mësimore dhe zhvillimore.

4. Kurset pedagogjike/didaktike

Kurset pedagogjike/didaktike për ndërtimin kapaciteteve të shkollave dhe palëve të tjera me interes në fushën e shkollimit të mesëm profesional janë më së të nevojshme

Kurset pedagogjike/didaktike të ofruara nga AAAPARR-ja (angazhim i ekspertëve adekuatë) nuk duhen parë si kontekste koherente ku ndërtimi i kapaciteteve të QK dhe shkollave profesionale dhe palëve të tjera me interes në shkollim të mesëm profesional përbëjnë pjesë integrale të intervenimit. Kurse e nevojshme të cilat mbulojnë lloje të ndryshme kompetencash u adresohen mësimdhënësve dhe drejtuesve të QK dhe shkollave profesionale të përkrahura përmes AAAPARR.

1. Rekomandohet që kurset të organizohen nga AAAPARR, të ftohen për pjesëmarrje përfaqësues nga MASHT-i dhe AAAPARR-së, Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) dhe përfaqësues të tjerë relevantë në mënyrë që të nxjerrin frymëzim dhe mësim lidhur me sistemin e licencimit të mësimdhënësve apo nismave të tjera që kanë të bëjnë me burimet njerëzore.
2. Fuqimisht rekomandohet përfshirja e inspektorëve të arsimit në tërë procesin e planifikimit, zbatimit dhe mirëmbajtjes së intervenimeve pedagogjike/didaktike. Siç u theksua edhe më parë, inspektorët e kanë kapacitetin dhe entuziazmin për të punuar në profesionalizimin e mësimdhënësve të shkollave profesionale. Të gjithë kanë qenë të përfshirë në kurset e GIZ-it të realizuara më herët.
3. Kurset përmbajnë disa pika themelore:
 - Kurset duhet të jenë bazike dhe të përkrijnë me kushtet aktuale në shkolla
 - Kurset shërbejnë si faktorë kyçë në procesin e përmirësimit të decentralizimit dhe vetëqeverisjes në shkollat e fokusuara
 - Kurset duhet t'u ofrojnë pjesëmarrësve vegla dhe materiale të cilat këta të fundit mund t'i përdorin praktikisht gjatë mësimdhënies së tyre të përditshme
 - Kurset duhet të përfshijnë leksione tradicionale, por të kenë një objektivi të qartë - përfshirjen e mësimdhënësve në aktivitete të ndryshme që kërkojnë pjesëmarrjen aktive të tyre
 - Përfshirje të mësimdhënësve në procesin e përshtatjes dhe përmirësimit të mësimdhënies së tyre
 - Vënie të kushteve për ripërtëritje të kurseve nga vetë shkollat, apo nga shkollat në bashkëpunim me partnerët relevantë.
4. Secili kurs/intervenim duhet të përshkruhet në kushte të përgjithshme, duke nënvizuar objektivat, përmbajtjen dhe rezultatet e pritura.
5. Kurset e rëndësishme që duhen zhvilluar:

Kursi për zhvillimin optimal të materialeve trajnuese

Kursi për promovimin dhe shfrytëzimin e qasjes së mësimdhënies se orientuar nga nxënësi

Kursi për shfrytëzimin e trajnimeve të bazuara në projekte

Kursi për punën me objektiva mësimore

3.1. Zhvillimi i kapaciteteve në shkolla profesionale, AAAPARr dhe MAShT

Shkollat profesionale luajnë rol kyç në sigurimin e kapitalit njerëzor në regjionet e tyre. Siç u theksua në kapitullin hyrës, hapja e shkollave kërkon ndryshim të profileve të mësimdhënësve dhe posaçërisht kërkon që mësimdhënësit të heqin dorë nga identiteti i tyre tradicional i të qenit transmetues - ekspert i dijenisë dhe shkathtësive të caktuara dhe të bëhen lehtësues dhe udhëzues të proceseve mësimore.

Për më tepër, vënia e theksit në kontekstet e rëndësishme shpie drejt një mjedisi të ri për mësimdhënësit në shkollat profesionale. Shkollat janë vend i përshtatshëm në të cilin mësimdhënësit mund të mësojnë, me kusht që organizimi i punës brenda hapësirave të shkollave t'i ofrojë mundësi stafit për t'i ngritur kapacitetet e tyre, e jo thjesht për t'i kryer detyrat e tyre. Kurset e paraqitura në vijim nuk duhen parë si intervenime të ndara, por në kontekst të ngritjes së kompetencave pedagogjike/didaktike në një proces ngushtë të lidhur me ngritjen e kapaciteteve vetëqeverisëse të shkollave dhe AAAPARr-së.

Veç tyre, është theksuar fakti se AAAPARr-ja ka përgjegjësi për zhvillimin profesional të mësimdhënësve të shkollave profesionale në fazën pilote për 6 IAAP në tri fushat në vijim:

- Rekrutimin/punësimin dhe dhënien e pagave për punonjësit administrativë dhe mësimdhënës në shkolla
- Trajnimin e stafit mësimdhënës dhe administrativ
- Monitorimin e punës së mësimdhënësve

Duke marrë pjesë në punëtoritë e organizuara për mbajtjen e kurseve, AAAPARr, MAShT dhe Instituti Pedagogjik merren informata të dobishme jo vetëm lidhur me sistemin konkret të licencimit, por edhe me fusha të tjera si zhvillimi i shkollave dhe përkrahja e shkollave profesionale në marrjen e iniciativave vetjake sa i përket promovimit të kompetencave të mësimdhënësve dhe bashkëpunimit me tregun lokal të punës. Përveç pjesëmarrjes në aktivitete, duhet të mbahen punëtori të ndara me të gjithë bartësit relevantë:

- Një para fillimit të programit
- Një para secilit kurs
- Një pas kursit të fundit.

Objektivë e këtyre punëtorive duhet të jetë paraqitja e qasjes së intervenimit, me fokus kryesor në mënyrën në të cilën palët e ndryshme me interes mund të adoptojnë dhe eventualisht t'i vazhdojnë aktivitetet trajnuese me financim nga donatorët.

<p>Kursi 1: Zhvillimi i materialeve të reja të trajnimit - qasjet e reja ndaj mësimdhënies</p> <p>Materialet e reja të trajnimit duhen zhvilluar. Fokusimi në gjetjen e mënyrave për zhvillimin optimal të materialeve mësimore dhe për lidhjen më të mirë mes teorisë në libra me tregun lokal të punës.</p> <p>Kujdes duhet t'i kushtohet edhe mënyrës së bartjes së dijenisë dhe shkathtësive përmes AAAPARr-s tek shkollat dhe palët e tjera me interes në komunë.</p> <p>Fokusi në materialet mësimore dhe ndërlidhja me trajnim praktik</p>	<p>Kursi 2: Si të promovohet dhe të shfrytëzohet më së miri qasja e fokusuar tek nxënësi</p> <p>Korniza metodologjike e kursit përbëhet nga ndryshimi i rolit të mësimdhënësve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si të përkrahen nxënësit në marrjen përsipër të kontrollit mbi proceset mësimore të veta • Demonstrimi dhe diskutimi mbi mënyrat e përfshirjes aktive të nxënësve në proces • Si mësimdhënësi mund të bëhet person që lehtëson procesin dhe gjen resurset përkatëse për nxënësit <p>AAAPARr-ja duhet të përfshihet për shkak se duhet të paraqesë proces mësimor që mund t'i kontribuojë ndryshimit të mjedisit mësimor jo vetëm brenda shkollës profesionale, por edhe në kontekst më të gjerë.</p> <p>Fokusi në rolet e reja për mësimdhënësit dhe qasjet inovative për mësimnxënie</p>
<p>Kursi 3: Si të shfrytëzohet trajnimi i bazuar në projekte</p> <p>Mësimi i bazuar në projekte (MBP) është shfrytëzimi i projekteve të detajuara dhe të kujdesshme të zhvilluara në klasë për të ndihmuar të mësuarit dhe për të vlerësuar dijeninë e nxënësit.</p> <p>MBP definohet më si miri si mësim i cili ndërlidh pyetjet dhe teknologjinë nga jeta e përditshme e nxënësve me projektet në klasë. Nxënësit gjejnë mënyra për të hulumtuar vetë grupet e tyre, gjë që u mundëson atyre zhvillimin e shkathtësive të dobishme zbuluese.</p> <p>MBP ndërthen komunikim dhe ndërlidhje me tregun e punës dhe rrjedhimisht i ofron mundësi shkollës që ta ngrehë nivelin e bashkëpunimit me rrethin.</p> <p>Fokusi në ndërmarrësi</p>	<p>Kursi 4: Si të punohet me objektiva mësimore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohja e mësimdhënësve të shkollave profesionale me konceptin • Pajisja e mësimdhënësve të shkollave profesionale me mjete për t'i shtuar të kuptuarit e tyre mbi mënyrat e punës dhe mbi implementimin e planprogramit për profesionet e ofruara në shkollat profesionale bujqësore • Përmirësimi i të kuptuarit të mësimdhënësve të shkollave profesionale mbi atë se si objektivat mësimore mund të kenë ndikim pozitiv në procedurën e vlerësimit të njohurive teorike dhe praktike të nxënësve. <p>Fokusi në planprogram dhe vlerësim të nxënësve</p>

Rolet e mësimit dhe trajnimit janë duke kaluar nëpër ndryshime të mëdha, siç janë kalimi nga transmetimi i njohurive tek mundësimi i të mësuarit dhe kalimi nga trajnimet në bazë të planprogramit tek përcaktimi i objektivave mësimore të cilat nxënësit duhet t'i arrijnë pas përfundimit të procesit mësimor të lëndës. Në këtë proces, është esencial kalimi nga procesi mësimor i fokusuar tek mësimit në një proces mësimor të fokusuar tek nxënësi.

1. Kohëzgjatja

Përfshirë përgatitjen e një doracaku për instruktorë të kurseve të ngjashme do të përfshinte një kohë prej 5 ditëve.

2. Objektivat

- Pas kryerjes së kursit, pjesëmarrësit do të jenë më të gatshëm që këto njohuri t'i bartin tek të tjerët
- Pas kryerjes së kursit, pjesëmarrësit do t'i kenë shtuar njohuritë e tyre lidhur me identifikimin dhe përzgjedhjen e qasjeve mësimdhënëse, në pajtim me përmbajtjen e materialeve të trajnimit

3. Përmbajtja/aktivitetet

Pikënisje do të jenë materialet e reja mësimore dhe si të shfrytëzohen ato më së miri. Para fillimit të kursit do të identifikohen nevojat se cilat tekste mësimore dhe doracakë specifikë do të zhvillohen, të cilët do të shfrytëzohen si materiale përkrahëse në aktivitetet trajnuese.

Baza e këtij kursi do të jetë përpjekja për t'i përfshirë pjesëmarrësit (mësimitdhënësit e shkollave profesionale) për atë që është e mundur, dhe kufizimi i shfrytëzimit të metodave tradicionale të ligjërimit nga instruktori. Do të fokusohet në kapacitetet e pjesëmarrësve për t'i zgjidhur problemet përmes vetëmimit dhe punës ekipore. Sipas kësaj qasjeje, për t'u arritur shfrytëzimi efektiv i informatave të reja - ato duhet të jenë të kuptueshme, ndërsa informatat e kuptueshme zhvillohen në kontekst konkret, për shembull duke shfrytëzuar referencat ekzistuese ndaj tregut të punës.

Bazuar në materialet dhe planprogramin gjegjë, janë përcaktuar si caqe çështjet metodologjike në vijim:

- Si të planifikohet përmbajtja e një ligjërate, në kuptim të caktimit të caqeve, përmbajtjes, sfondit për nxënësit dhe aktivitetet e tyre?
- Qasjet e mësimitdhënies dhe procedurat e punës sipas planprogramit dhe materialeve të trajnimit
- Bartja e njohurive dhe dijenisë nga tekstet mësimore
- Si të motivohen nxënësit?

4. Materialet

- Shembuj relevantë nga tekstet e reja mësimore
- Prezantime dhe dokumente të cilat përcaktojnë parimet themelore metodologjike
- Rastet që demonstrojnë parimet bazike

5. Produktet

Një komplet udhëzimesh dhe këshillash se si të zbatohet ky kurs trajnimi.

Kursi për promovimin dhe shfrytëzimin e qasjes së mësimdhënies së orientuar nga nxënësi

1. Titulli: mësimdhënia e orientuar kah nxënësi - qasje inovative

2. Sfondi

Mësimdhënia që në qendër të fokusit e ka nxënësin është një qasje në arsim që kujdeset për nevojat e nxënësit dhe jo të palëve të tjera të përfshira në procesin arsimor, siç janë mësimdhënësit apo administratorët. Kjo qasje ka implikacione të shumta në dizajnimin e planprogramit, përmbajtjen e lëndës dhe ndërveprimit mes lëndëve.

Mësimdhënia e orientuar kah nxënësi, do të thotë vënia e nxënësit në rend të parë, është qasje e kundërt me atë të mësimdhënies që në qendër të vëmendjes e ka mësimdhënësin. Kjo qasje fokusohet në nevojat, aftësitë, interesat dhe mënyrat e të mësuarit të nxënësit, ndërsa mësimdhënësi është thjesht lehtësues i procesit mësimor. Kjo metodë e mësimdhënies vë zërin e nxënësit në fokus të përvojës mësimore të secilit nxënës. Mësimdhënia e orientuar kah nxënësi kërkon nga nxënësit të jenë pjesëmarrës aktivë dhe të përgjegjshëm të procesit mësimor.

3. Kohëzgjatja

Pesë ditë, përfshirë përgatitjen e një doracaku për instruktorë të kurseve të ngjashme në të ardhmen.

4. Objektivat

- Pas kryerjes së kursit, pjesëmarrësit do të kenë njohuri të gjera mbi parimet e të mësuarit të orientuar nga nxënësi
- Pas kryerjes së kursit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të organizojnë dhe realizojnë procese eksperimentale mësimore në fusha të caktuara
- Pas kryerjes së kursit, pjesëmarrësit do të mund t'i përkrahin nxënësit në procesin e reflektimit mbi praktikën mësimore të tyre.

5. Përmbajtja/aktivitetet

Korniza metodologjike e kursit është ndryshimi i rolit të mësimdhënësve. Bazuar në leksione të shkurtra teorike dhe demonstrime praktike, përmbajtja e kursit do të fokusohet në:

- Mënyrat për t'i përkrahur nxënësit në marrjen përsipër të kontrollit mbi procesin mësimor
- Demonstrimin dhe diskutimet lidhur me atë se si nxënësit të përfshihen në mënyrë aktive
- Mënyrën se si mësimdhënësi mund të bëhet facilitator dhe person që gjen resurset e nevojshme për mësim.

6. Materialet

- Shembuj relevantë nga tekstet e reja mësimore
- Prezantime dhe dokumente të cilat përcaktojnë parimet themelore metodologjike
- Rastet që demonstrojnë parimet bazike

7. Produktet

Një komplet udhëzimesh dhe këshillash se si të zbatohet ky kurs trajnimi

Kursi për shfrytëzimin e trajnimit të bazuar në projekte

1. Titulli: Trajnimi i bazuar në projekte si përkrahje për qasjet inovative të trajnimit dhe mësimit të ndërmarrësisë

2. Sfondi

Mësimi i bazuar në projekte (MBP) është shfrytëzimi i projekteve të detajuara dhe të zhvilluara me kujdes në klasë për të ndihmuar të mësuarit dhe për ta vlerësuar dijeninë e nxënësit. Nxënësit shfrytëzojnë teknologjinë dhe hulumtojnë për t'i gjetur përgjigjet për një çështje, problem apo sfidë komplekse. MBP fokusohet në pyetjet e nxënësit.

MBP definohet më së miri si mësim i cili ndërlihd pyetjet dhe teknologjinë nga jeta e përditshme e nxënësve me projektet në klasë. Nxënësit gjejnë mënyra për t'i hulumtuar vetë grupet e tyre, gjë që u mundëson atyre zhvillimin e shkathtësive të dobishme zbuluese. Nxënësit angazhohen në dizajnim, gjetje të problemit, vendimmarrje dhe hulumtim. Kjo u mundëson nxënësve punën në grupe apo punën individuale dhe u jep mundësi që t'i paraqesin idetë apo zgjidhjet reale për çështje të caktuara. Nxënësit e marrin një problem dhe përmes këtyre projekteve e aplikojnë atë në kushte të jetës së përditshme.

Qeveria e Kosovës e ka vënë ndërmarrësinë lart në agjendën arsimore, në kuptimin e asaj se ndërmarrësia do të integrohet në arsimin e mesëm. Arsyeja për këtë është ofrimi i mundësive të punësimit në sektorin privat apo publik për të diplomuarit në shkollat e mesme. Duke përcaktuar lëndët/aktivitetet të cilat nxisin mendimin ndërmarrës tek nxënësit. Qeveria dëshiron ta promovojë krijimin e bizneseve nga të rinjtë që, përndryshe, do të mbesnin të papunësuar pas përfundimit të shkollimit të mesëm.

Përvoja nga vendet e tjera na tregon se aspektet/lëndët ndërmarrësore më së miri mund të shfrytëzohen kur ato integrohen në lëndë/projekte të tjera, e jo kur jepen si lëndë autonome në planprogramin mësimor.

3. Kohëzgjatja

Pesë ditë, përfshirë edhe përgatitjen e një doracaku për instruktorë të kurseve të ngjashme në të ardhmen.

4. Objektivat

- Sajimi i konceptit të MBP në bashkëpunim me mësime ndërmarrësit në shkolla profesionale
- Njohja e mësime ndërmarrësve të shkollave profesionale me MBP
- Pajisja e mësime ndërmarrësve të shkollave profesionale me njohuritë e domosdoshme për t'i implementuar aktivitetet e parapara sipas MBP-s.

5. Përmbajtja/aktivitetet

Është me rëndësi që MBP të ketë lidhje me botën reale. Kjo do të arrihet përmes ndërlidhjes së saj me përvoja të vërteta jetësore apo me situata të cilat mund të jenë tipike për grupmoshën në fjalë. Sa iu përket shkollave profesionale, nxënësit e tyre janë të moshave mes 15 dhe 18-vjeçare dhe kanë pak njohuri mbi tregun lokal të punës apo tiparet e tij. Megjithatë, trajnimi/edukimi i ofruar në shkolla ka për qëllim punësimin e tyre në kompanitë lokale. Kjo duhet të reflektohet në strukturën e këtij kursi.

Pasi që MBP-ja trajton sfidat dhe zgjidhjen e problemeve në raste që shpesh formulohen nga vetë nxënësit, parashihet që pjesë e këtij kursi të jenë edhe vetë nxënësit, mbase jo gjatë tërë procesit, por në raste të caktuara kur përfshirja e nxënësve konsiderohet si e rëndësishme.

Kursi për punën me objektiva mësimore

1. Titulli: Si të punohet me objektiva mësimore

- Sfondi:** Në disa aspekte kyçe objektivat mësimore përbëjnë pjesë të qasjes inovative ndaj mësimdhënies dhe të mësuarit. Objektivat mësimore janë në qendër të synimeve sistematike, planprogramit, pedagogjisë, vlerësimit dhe mëtimin për të siguruar cilësi.

Shtimi i shfrytëzimit të objektivave mësimore pritet të ketë ndikim të theksuar në fokusimin e mëtejshëm të sistemit drejt atij të cilit i ofrohet mësimi, në organizimin e institucioneve, planprogrameve dhe roleve të trajnuesve dhe mësimdhënësve dhe në trajnimin e tyre.

Qasja objektivave mësimore po fiton më shumë rëndësi në mjediset evropiane ku sistemet arsimore dhe të aftësisë po lëvizin drejt strategjive të të mësuarit gjatë tërë jetës.

Objektivat mësimore duhet kuptuar si koleksion i proceseve dhe veglave të dobishme të cilat mund të aplikohen në mënyra të ndryshme në rrethana politike, të mësimdhënies apo të të mësuarit. Si rrjedhojë, nuk ekziston ndonjë qasje e cila mund të konsiderohet si qasja e vetme adekuate për t'iu qasur. Ky term mund të ketë konotacione dhe kuptime të ndryshme, pikërisht për faktin se shfrytëzohet në kontekste të ndryshme.

Vlen të theksohet se objektivat mësimore gjithashtu kryejnë funksione të shumta në sistemet arsimore dhe aftësuese në shtetet evropiane, përfshirë: njohjen e të mësuarit paraprak, dhënien e kredive, cilësinë, planet mësimore, kapacitetet përkatëse jetësore, kredibilitetin e punonjësve si dhe modernizimin e sistemit të arsimit, pasi që këto sisteme janë reformuar për ta përfshirë mësimin gjatë tërë jetës së konceptit.

Sistemi i arsimit profesional në Kosovë është duke u përballur me reformë për ca kohë, me qëllimin primar të sigurimit të përmirësimeve cilësore dhe sasiore në shkollat e mesme profesionale. Kjo do të duhej t'i bëjë bizneset më konkurruese dhe ta zvogëlojë papunësinë, veçanërisht papunësinë e të rinjve.

Brengë kyçe për Qeverinë e Kosovës është nevoja për t'ia përshtatur arsimin profesional nevojave të tregut të punës. Duke ofruar trajnime sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF, KEK), mendohet që Kosova të bëhet vend atraktiv për investuesit dhe ta shtojë mobilitetin e fuqisë punëtore të saj. Objektivat mësimore përbëjnë edhe një nga pikat fundamentale të KEK-së.

3. Kohëzgjatja

Pesë ditë, përfshirë përgatitjen e doracakëve për instruktorë të kurseve të ngjashme në të ardhmen.

4. Objektivat

- T'u prezantohet koncepti mësimdhënësve të shkollave profesionale
- Të pajisen mësimdhënësit e shkollave profesionale me mjete për t'i shtuar njohuritë e tyre mbi punën në shkolla profesionale për profilet adekuate dhe zbatimin e planprogrameve gjegjëse
- Të ngrihet niveli i njohurive të mësimdhënësve në shkolla profesionale në lidhje me atë se si objektivat mësimore mund t'u ndihmojnë në procedurat e vlerësimit të njohurive praktike dhe teorike të nxënësve.

5. Përmbajtja/aktivitetet

Ky kurs bazohet në probleme, që do të thotë se duhet të ketë si pikënisje ndonjë sfidë relevante të mësimdhënësve.

Kursi fokusohet në punën me objektiva mësimore, p.sh., si të shndërrohen objektivat mësimore në njohuri, shkathtësi dhe kapacitete.

Ky kurs do të përfshijë një sërë ushtrimesh që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve për të reflektuar më shumë në performancën e tyre në kuptim të të mësuarit.

Ky kurs do të fokusohet në aktivitete të cilat mund t'i ndihmojnë mësimdhënësit në planifikimin dhe realizimin e asaj që është e domosdoshme për t'i përkrahur nxënësit në mësimet e tyre.

Objektivat	Logjika e intervenimit	Treguesit verifikueshëm	Rreziqet/supozimet rëndësishme
<p>Objektiva të intervenimit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Shtimi i kapaciteteve bazike pedagogjike/didaktike të mësimdhënësve të shkollave profesionale që marrin pjesë në kurse Shtimi i kapaciteteve të shkollave për decentralizim dhe vetëqeverisje Ofrimi i mundësisë për shkollat profesionale pjesëmarrëse që të mbajnë kurse të ngjashme pa ndihmë të jashtme Kontributi në ngritjen e kapaciteteve të AAAPARR-së, MASHT-it dhe/ose KEC-it, në kuptim të ofrimit të informatave dhe frymëzimit për ide të zhvillimit profesional të mësimdhënësve të shkollave profesionale 	<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e materialeve dhe programeve Përgatitja e listës së pjesëmarrësve Konsultimi me menaxhmentin dhe mësimdhënësit e shkollës para intervenimit Përgatitja e orarit Kompletimi i skemës vlerësuese dhe testimi i saj 	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i intervenimit Reagimet e pjesëmarrësve Intervistat me persona kyçë Përgatitja dhe testimi i kompletit të kuptuarit e përbashkët të koncepteve pedagogjike Planet e shkollave profesionale për ta vazhduar zhvillimin profesional të mësimdhënësve Shtimi i nivelit të vetëqeverisjes në shkolla profesionale Pjesëmarrja aktive e AAAPARR-s në aktivitetet në shkollat gjegjëse 	<ul style="list-style-type: none"> Interesimi i mësimdhënësve të shkollave profesionale për kursin Mësimdhënësit e shkollave profesionale kanë mundësi të pjesëmarrjes në kurse MASHT-i dhe bartësit e tjerë shfaqin interes për të marrë pjesë në aktivitete AAAPARR-ja shfaq interesim për aktivitetet Mësimdhënësit e shkollave profesionale kanë mundësi të pjesëmarrjes

Korniza logjike për intervenimet e propozuara

Shtojca A - Materialet e shqyrtuara

Raportet nga trajnimet e mbajtura

Autori/institucioni	Titulli
Kuvendi i Kosovës	Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional
Qendra Evropiane për Zhvillimin e Arsimit Profesional - CEDEFOP	Sigurimi i cilësisë dhe nevojave mësimore për mësimdhënësit dhe trajnuesit e shkollave profesionale
ETF - Fondacioni Evropian për Trajnime	Politikat dhe praktikat për përgatitjen e mësimdhënësve për arsim përfshirës, në kontekst të diversitetit kulturor dhe social Raporti Shtetëror për Kosovën
Projekti <i>EU EDUCATION SWAp</i> - qershor 2010	Raport për vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve në drejtoritë komunale të arsimit
Komisioni Evropian - 2009	Shtimi i kapaciteteve për shekullin XXI - agjenda për bashkëpunim evropian
Programi Kosvet III	Buletini afatmesëm
Organizata Ndërkombëtare e Punës - ILO - 2010	Mësimdhënësit dhe trajnerët e së ardhmes - arsimimi teknik dhe profesional në botën që po ndryshon
Oda Ekonomike e Kosovës	Përkrahje për qendrën VET dhe komitetin e arsimit të përgjithshëm
MASHT/AAAPARr, Kosovë, 2015	Udhëzues për përkrahjen e vetëqeverisjes në shkollat profesionale